

Detyra e caktuar

## Njësia 5: Zhvillimi i WEB Faqeve

Niveli i 4 i KKK

**Koha e sugjeruar:**

20 orë brenda 2 javëve

Plotësohet nga British Gymnasium of Technology

Data e vlerësimit:

## Udhëzime për mësuesit/tutorët dhe/ose mbikëqyrësit

Detyra e caktuar do të vlerësohet brenda qendrës duke përdorur kriteret e vlerësimit të njësisë që janë dhënë në përshkrimin e kualifikimit. Kjo detyrë do të ekzaminohet nga Verifikuesi i Standardeve si pjesë e vizitës vjetore të qendrës për kontroll të implementimit të standardeve.

### **Kushtet e mbikëqyrjes**

Detyra e caktuar duhet të kryhet nën kushte të mbikëqyrura. Mund të realizohet në më shumë se një sesion të mbikëqyrur.

Detyra e caktuar nuk do të ndahet me nxënësit përpara seancës së mbikëqyrur që do të organizohet nga qendra. Mësuesit/tutorët dhe mbikëqyrësit e kanë parasysht se ata janë përgjegjës për ruajtjen e sigurisë dhe për raportimin e problematikave tek menaxhmenti i British Gymnasium of Technology.

### **Rezultatet për dorëzim**

Nxënësit duhet ta kryejnë këtë detyrë të caktuar në një kompjuter të vendosur në shkollë, duke përdorur softuerin produktiv të zyrës dhe hapësirat e shkollës për zhvillim. Nxënësit duhet ta ruajnë punën e tyre rregullisht dhe të sigurojnë që të gjitha materialet të mund të identifikohen si punë të tyre.

Nxënësit duhet të paraqesin punën e tyre të pavarur siç detajohet në detyrën e caktuar.

## Udhëzuesi për nxënës

Lexoni me kujdes informacionin e detyrës së caktuar.

Do t'ju kërkohet të kryeni aktivitete specifike me shkrim, në kushte të mbikëqyrura, duke përdorur informacionin e dhënë.

Ju duhet të punoni në mënyrë të pavarur gjatë gjithë kohës dhe nuk duhet ta ndani punën tuaj me nxënësit e tjerë. Duhet të kryeni TË GJITHA aktivitetet.

## Kriteret e vlerësimit

Kalon (K)	Me meritë (M)	Dalluar (D)
<b>Rezultatet e mesimnxënies 1 (RM1):</b> Të kuptojë parimet e zhvillimit të WEB faqes		
<b>RM1.K1</b> Krahasoni parimet e dizajnit të WEB faqeve të përdorura në dy WEB faqe, duke përfshirë përshtatshmërinë e tyre për audiencën e synuar dhe qëllimin e synuar.	<b>RM1.M1</b> Analizoni se si parimet e dizajnit të WEB faqes përdoren për të prodhuar WEB faqe kreative, me performancë të lartë që plotësojnë kërkesat e klientit.	<b>RM1.D1</b> Vlerësoni se si përdoren parimet e dizajnit të WEB faqes për të prodhuar WEB faqe kreative, me performancë të lartë që plotësojnë kërkesat e klientit
<b>Rezultatet e mesimnxënies 2 (RM2):</b> Dizajnoni një WEB faqe për të përmbushur kërkesat e klientit		
<b>RM2.K2</b> Prodhoni dizajne për një WEB faqe që plotëson kërkesat e klientit. <b>RM2.K3</b> Rishikoni propozimet e dizajnit të WEB faqes me personat e tjerë për të identifikuar dhe raportuar përmirësimet.	<b>RM2.M2</b> Arsyetoni vendimet e dizajnit, duke shpjeguar se si ato do të plotësojnë nevojat e përdoruesit dhe do të jenë të përshtatshme për qëllimin.	<b>BC.D2</b> Vlerësoni dizajnin dhe WEB faqen të optimizuar kundrejt kërkesave të klientit.
<b>Rezultatet e mesimnxënies 3 (RM3):</b> Zhvilloni një WEB faqe për të përmbushur kërkesat e klientit		<b>BC.D3</b> Demonstroni përgjegjësi individuale, kreativitet dhe vetë-menaxhim efektiv në dizajnimin, zhvillimin dhe rishikimin e një WEB faqe.
<b>RM3.K4</b> Krijoni një WEB faqe për një audiencë të synuar dhe testoni WEB faqen për funksionalitetin, përputhshmërinë dhe qëllimin e përdorshmërisë. <b>RM3.K5</b> Testoni WEB faqen për funksionalitet, përputhshmëri dhe përdorshmëri. <b>RM3.K6</b> Rishikoni masën në të cilën faqja e internetit përmbush kërkesat e klientit.	<b>RM3.M3</b> Optimizoni një WEB faqe për të përmbushur kërkesat e klientit.	

<p><b>Shërbimet e ofruara</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimet e rrezikut të sigurisë</li> <li>• Shitja dhe instalimi i sistemeve të sigurisë (alarme dhe CCTV)</li> <li>• Mirëmbajtja e sistemit të sigurisë</li> <li>• Monitorimi 24/7 i: <ul style="list-style-type: none"> <li>o Sistemeve të alarmit</li> <li>o Pamjeve nga CCTV-të</li> </ul> </li> </ul>
<p><b>Produktet</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Paketa bazë e sigurisë <ul style="list-style-type: none"> <li>o 1 x sistem alarmi</li> <li>o 1 x kamera CCTV</li> <li>o Ruajtja lokale e pamjeve CCTV</li> <li>o NUK monitorohet nga qendra</li> </ul> </li> <li>• Paketa standarde e sigurisë: <ul style="list-style-type: none"> <li>o 1 x sistem alarmi</li> <li>o 2 x kamera CCTV</li> <li>o Ruajtja në internet dhe lokale e pamjeve CCTV</li> <li>o NUK monitorohet nga qendra</li> </ul> </li> <li>• Paketë sigurie deluxe <ul style="list-style-type: none"> <li>o 1 x sistem alarmi</li> <li>o 4 x kamera CCTV</li> <li>o Ruajtja në internet dhe lokale e pamjeve CCTV</li> <li>o Monitorohet nga qendra</li> </ul> </li> <li>• Sistemet e personalizuara të sigurisë – klientët duhet të kontaktojnë me kompaninë për të organizuar një takim vlerësues dhe planifikues.</li> </ul>
<p><b>Kërkesat fillestare të WEB faqes</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• dizajn modern dhe atraktiv</li> <li>• të ndihmojë në përmirësimin dhe promovimin e markës së kompanisë</li> <li>• t'u ofrojë klientëve të mundshëm informacione rreth: <ul style="list-style-type: none"> <li>o kompanisë</li> <li>o shërbimeve të ofruara</li> <li>o ndihmës dhe këshillave të përgjithshme për sigurinë.</li> </ul> </li> <li>• të mundësojë që klientët të kontaktojnë kompaninë për të kërkuar më shumë informacione</li> <li>• një ekspozim rezonanziv të përshtatshëm për përdoruesit që qasen ose me telefon mobil ose me kompjuter</li> <li>• veçoritë për qasje të lehtë për të mundësuar një gamë të gjerë përdoruesish të përdorin WEB faqen lehtësisht</li> </ul>

**Duhet të kryeni TË GJITHA aktivitetet.**

### **AKTIVITETI 1**

Pronarët e kompanisë Siguria, janë shumë të interesuar të kenë një WEB faqe me cilësi të lartë dhe kanë kërkuar nga ju t'u jepni atyre informacion se si WEB faqet e tjera plotësojnë nevojat e pronarëve të WEB faqes.

Ju duhet të hulumtoni dy WEB faqe që kanë një qëllim të ngjashëm dhe/ose në një zonë të ngjashme biznesi.

Ju duhet të:

- Krahasoni dizajnin dhe veçoritë e WEB faqeve të identifikuar
- Merrni parasysh përshtatshmërinë e veçorive dhe dizajnit të WEB faqeve për qëllimin e synuar dhe audiencën.
- Analizoni se si përdoren parimet e dizajnit dhe zhvillimit të WEB faqes.
- Siguroni një vlerësim të mbështetur se sa mirë çdo WEB faqe i plotëson nevojat e pronarit të WEB faqes dhe përdoruesve të tij.

Ju duhet të merrni parasysh çdo aspekt pozitiv ose negativ të dy WEB faqeve. Përdorni shembuj specifikë prej tyre për të mbështetur pikat që ju theksoni në raportin tuaj.

Ky aktivitet mbulon rezultatet e mësimnxënies: RM1.K1, RM1.M1, RM1.D1

### **AKTIVITETI 2**

Pronarët e kompanisë Siguria, dëshirojnë të shohin disa dizajne fillestare për WEB faqen para se ju të filloni ta zhvilloni atë.

Krijoni dizajne gjithëpërfshirëse për WEB faqen të cilat përfshijnë:

- identifikimin e kërkesave të përdoruesve
- dizajne vizuale për WEB faqet
- opsione alternative të dizajnit
- dokumentim teknik.

Ju duhet të përdorni informacionet e detyrës së caktuar dhe atë që keni mësuar përmes hulumtimit tuaj në Aktivitetin 1 për t'i informuar për planet tuaja.

Ky aktivitet mbulon rezultatet e mësimnxënies: RM2.K2

### **AKTIVITETI 3**

Tani duhet të kërkonte komente për të përmirësuar cilësinë dhe përshtatshmërinë e dizajnit tuaj.

Ju duhet të:

- prezantoni dizajnin tuaj tek të tjerët
- mblidhni dhe analizoni komentet që merrni
- identifikoni pjesët e dizajnit që mund të përmirësohen
- zhvilloni/përmirësoni më tej dizajnin tuaj duke përdorur komentet e dhëna.

Ju duhet të jepni justifikimin e vendimeve tuaja rreth dizajnit, duke përfshirë mënyrën se si jeni përgjigjur në raport me ndonjë komentet që keni marrë.

Ju duhet të përfshini:

- se si dizajnet do të plotësojnë nevojat e përdoruesve dhe do të jenë të përshtatshme për qëllimin
- shqyrtimin i opsioneve alternative të dizajnit
- cilat ndryshime në bazë të sugjerimeve i keni bërë, cilat nuk i keni bërë dhe pse.

Kjo mund të jetë në formën e shënimeve në dizajn ose si një pjesë shtesë e shkruar si dëshmi.

Ky aktivitet mbulon rezultatet e mësimnxënies: RM2.K3, RM2.M2

### **AKTIVITETI 4**

Tani ju duhet të zhvilloni WEB faqen për klientin.

Gjatë zhvillimit të WEB faqes ju duhet të:

- Krijoni WEB faqen duke përdorur mjete dhe përmbajtje të përshtatshme
- Përdorni planet e duhura të testimit, oraret e testimit dhe të dhënat për të testuar WEB faqen rreth:
  - funksionalitetit
  - pajtueshmërisë (me pajisje dhe shfletues të ndryshëm)
  - përdorshmërisë (përfshirë testimin e përdoruesit).

Ju gjithashtu duhet të kërkonte sugjerime në mënyrë që të përmirësoni cilësinë dhe përshtatshmërinë e WEB faqes suaj të internetit.

Ju duhet të:

- prezantoni WEB faqen e juaj tek të tjerët
- mblidhni dhe analizoni komentet që merrni
- identifikoni pjesët e WEB faqes që mund të përmirësohen
- zhvilloni/përmirësoni më tej dizajnin tuaj duke përdorur komentet e dhëna.

Gjatë aktiviteteve të testimit dhe komenteve, ju duhet të mblidhni çdo rezultat dhe koment që keni marrë dhe të dokumentoni se si jeni përgjigjur ndaj çdo problemi ose gabimi të identifikuar.

Këto prova duhet të përfshijnë:

- versionet "para" dhe "pas" të WEB faqes që tregojnë ndryshimet e dukshme të bëra gjatë zhvillimit
- detaje se si uebsajti është 'Optimizuar' bazuar në rezultatet e testimit dhe komenteve të përdoruesit

Ky aktivitet mbulon rezultatet e mësimnxënies: RM3.K4, RM3.K5, RM3.M3

## **AKTIVITETI 5**

Zhvillimi i WEB faqes tani ka përfunduar dhe menaxheri juaj ju ka kërkuar ta rishikoni masën në të cilën projekti plotëson nevojat e klientit.

Shkruani një vlerësim të dizajnit, zhvillimit dhe optimizimit të WEB faqes.

Vlerësimi i juaj duhet të:

- Të paraqes se sa efektiv është faqja e internetit në:
  - plotësimin e kërkesave të klientit
  - plotësimin e nevojat e audiencës së synuar
  - arritjen e qëllimit të deklaruar
- Krahasoni veçoritë përfundimtare të WEB faqes me zgjidhjet e tjera që mund të ishin përdorur
- Jepni një vlerësim të detajuar dhe të balancuar të pjesës ku faqja funksionon mirë dhe pjesëve për të cilat duhet përmirësim.
- Rishikoni aftësitë, performancën dhe veprimet e juaja, si dhe ndikimin që kjo ka në zhvillimin e WEB faqes përfundimtare të internetit.

Vlerësimi juaj duhet të mbështetet me dëshmi nga të gjitha fazat e projektit për t'u arritur konkluzionet dhe sugjeruar zhvillimet.

Ky aktivitet mbulon rezultatet e mësimnxënies: RM3.K6, RM2.RM3.D2, RM2.RM3.D3